



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 23.11a.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË NDËRMARRJES
PUBLIKE NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a, në konsultim me Ndhimës Auditoren e Përgjithshme *Vlora Mehmeti* e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Luljeta Morina dhe Senver Morina, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	31
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	32
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	35
Shtojca IV: Letër konfirmimi	37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ndërmarrjes Publike Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a (tutje, Ngrohtorja) për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 28/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ngrohtores.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Çështje të Tjera

Pasqyrat financiare vjetore të Ngrohtores për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryesuesit të Bordit - auditimi 2016

Kryesuesi i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) kur PFV-të dorëzohen në Bordin e Drejtorëve.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i Kualifikuar

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Ngrohtores për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat vjetore financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parmit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për Opinion të Kualifikuar

Ne kemi krijuar bazën për opinion të kualifikuar, për arsyt e përmendura në vijim:

- Nga 35 letër konfirmimet e dërguara ne kemi pranuar vetëm gjashtë konfirmime, njëra ka vetëm qarkullim vjetor, ndërsa tri tjera janë të mbivlerësuara në vlerë prej 34,982€ dhe dy tjera të nënvlerësuara prej 6,513€. Kjo për shkak se nuk janë bërë harmonizimet e duhura me kohë apo disa nga klientët në mungesë të evidencave nuk i kanë raportuar borxhet e vjetra. Kjo nuk ofron siguri se të arkëtushmet japin një gjendje të saktë dhe të plotë.

- Një obligim tjetër afatshkurtër ishte prezantuar në PVF e 2016 si 78,737€ që ka të bëjë me detyrimin për tatimin në korporata i cili daton prej vitin 2012, 2013, 2014 si obligim i prapambetur për arsye të moskryerjes së borxhit me kohë. Kjo gjendje ka ndryshuar, është rritur për detyrimin e tatimit në fitim nga vlera fillestare që ishte 55,147€, si pasojë e kontrollit nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), për shkak të kalkulimit jo të duhur të shpenzimeve të zhvlerësimit për vitet e mëhershme dhe ne nuk mund të ofrojmë siguri për gjendjen fillestare të kësaj llogari.
- Vlera e borxhit të bartur për shpenzimin e rrymës nga vitet e kaluara nuk përputhet midis faturimit të furnitorit dhe kontabilitetit. Sipas kartelës së furnitorit kalkulimi i borxhit në kontabilitet ishte 119,131€, ndërsa sipas faturave nga KEDS/KEK ishte 114,388€ (ky borxh kryesisht nuk ishte paguar KEK-ut). Mblidhja e mbivlerësimit prej 4,743€ ka rrjedh si pasojë e gabimeve kontabël nga e kaluara dhe në mungesë të regjistrave analitik deri në 2010, Ngrohtorja ka hasur në vështirësi për të aplikuar harmonizimin me furnitorin.
- Ngrohtorja për shpenzimet e ujit në kontabilitetit kishte prezantuar detyrim të pa paguar vlerën 47,009€, e cila nuk përputhet me borxhin e evidentuar në fatura sipas furnitorit 51,039€. Në kontabilitet llogaria e paguar ka një nënvlerësim prej 4,030€. Kjo si pasojë e mungesës së evidencave nga e kaluara dhe ndërrimet e programit të kontabilitetit në vitin 2010 ku nuk ishin inkorporuar evidencat analitike por vetëm gjendjet, e cila shkakton vështirësi për të kryer një harmonizim midis palëve.
- Ndërmarrja nuk kishte arritur të azhurnoj regjistrin e pasurisë dhe në mungesë të një regjistri të kompletuar ne nuk jemi në gjendje të ofrojmë siguri për vlerën e pasurisë.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Ndërmarrjeve Publike në Kosovë, ZKA është e pavarur nga NP dhe përgjegjësitë tjera etike i janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmia e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të kualifikuar.

Çështje të Tjera

Pasqyrat Financiare Vjetore të Ngrohtores për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të kualifikuar të këtyre pasqyrave financiare me 18 prill 2016, për shkak të shpalesjes: në shënimin shtatë (7) për pamundësinë e inkasimit të llogarive të arkëtueshme; në shënimin tetë (8) mos përputhja e të arkëtueshmeve tjera me gjendjen e ATK-së; dhe në shënimin 14 për mospërputhje në mes të KMSH-së dhe gjendjes së ATK-së.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe PFV-të

Kryesuesi i Bordit të Ngrohtores është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PFV sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligët e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parmit akrual² të kontabilitetit si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit tonë. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse PFV në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi lidhur me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

² Parimi akrual - Njohja e transaksioneve dhe ngjarjeve janë të raportuara kur ato të ndodhin e jo kur para ja e gatshme është pranuar ose paguar.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime); dhe
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nga Ngrohtorja kërkohet të përgatisin:

- Statutin e NP-ës;
- Planin e Biznesit;
- Raportet tremujore me kohë;
- Raportet operative (të performancës);
- Raportin vjetor;
- Raporti nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
- Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

Në Memorandumin tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 23/12/2016, ne kemi ngritur disa çështje lidhje me pasqyrat financiare të cilat mund të kenë ndikim edhe në opinion. Çështjet e ngritura nuk ishin adresuar tërësisht. Si pasojë, në draft pasqyrat financiare të datës 15/02/2017 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me disa gabime. Përkundër sugjerimeve tona për ti bërë veprimet e nevojshme, ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, PFV të përgatitura nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të tyre në Bordin e Drejtorëve, mund të konsiderohen të sakta përveç çështjeve që janë identifikuar te baza për opinion.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, Ngrohtorja kishte përmbushur kërkesat e lartshënuar, përveç raportit për matjen e kënaqshmërisë së Konsumatorëve e cila nuk ishte përfunduar ende.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Rekomandimi 1 **Prioritet i lartë** - Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e opinionit të Kualifikuar. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet dhe për ta siguruar vlerësimin e saktë të llogarive të arkëtueshme, të pagueshme dhe të pasurive.

Rekomandimi 2 **Prioritet i lartë** - Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. PFV-të duhet të aprovohen nëse ndaj draftit të tyre janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Ngrohtoren që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjithë auditimin për të përcaktuar cilësinë e raporteve të ndryshme të Ndërmarrjes në përgjithësi.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë kontrollet e brendshme. Ndarjes së detyrave, përmbushjen e kërkesave (kënaqëshmërisë) të konsumatorëve; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Ngrohtores veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut. Raportet e ndryshme të plotësuara nga Ngrohtorja, e pasqyrojnë këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve që bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura.

Qeverisja në Ngrohtore në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe identifikimin e rreziqeve, pasqyron një situatë pozitive. Mirëpo, Ngrohtorja nuk kishte arrit të zbatoj të gjitha rekomandimet si dhe nuk ka përgatitur ndonjë plan për menaxhim të rrezikut, edhe përkundër që janë identifikuar disa rreziqe domethënëse që mund të kenë ndikim tek ndërmarrja në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Auditimi i Brendshëm nuk ishte themeluar dhe kjo nuk ofron një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti i auditimit të jashtëm³ për PFV-të të vitit 2015 të Ngrohtores ka rezultuar me katër (4) rekomandime kryesore. Ngrohtorja nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të vitit Ngrohtorja kishte arritur të zbatoj një (1) rekomandim ndërsa tri (3) rekomandimet e tjera ishte në proces të zbatimit. Vetëm rekomandimi lidhur me barazimet në mes të zërit për tatimet e arkëtueshmeve (kërkesat ndaj ATK) dhe gjendjen e ATK-së ishin zbatuar plotësisht. Përderisa, tri rekomandimet e tjera lidhur me analizimin e të arkëtueshmeve të pa mbledhshmëve, harmonizimet në pasqyrën e të ardhurave për Koston e Mallit të Shitur (KMSH) me atë të prezantuar në raportin e ATK-së, dhe vendosjen e një maksimumi të arkës për mbajtjen e parasë së gatshme, ishin zbatuar pjesërisht.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraparak - Prioritet i mesëm

E gjetura	Deri në fund të vitit Ngrohtorja kishte arritur të zbatoj një (1) rekomandim, përderisa tri (3) rekomandimet e tjera ishin në proces, kjo për shkak se Ngrohtorja nuk është duke ndjekur një proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm.
Rreziku	Zbatimi i pjesshëm i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërlidhen me pasqyrat financiare vjetore.
Rekomandimi 3	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që është përpiluar dhe zbatuar plani i veprimit, nëse paraqitet nevoja i njëjti plan duhet të rishikohet duke përcaktuar saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Jashtëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.2 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Ngrohtorja operon dhe sfidat me të cilat përballet.

³ Raporti i auditimit të jashtëm - Auditimin e PFV të Ngrohtores për vitit 2015 e kishte bërë një kompani private audituese dhe jo ZKA, dhe raportimi i tyre ka përfshirë një raport me opinionin dhe një letër për menaxhmentin ku janë prezantuar të gjeturat me rekomandime.

2.2.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Sipas ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ngrohtorja duhet të përgatis një Plan Biznesi për vitin e ardhshëm kalendarik. Ky plan duhet të miratohet nga Bordi i Drejtorëve deri me 31 Tetor të çdo viti kalendarik.

Çështja 4 - Mangësi në planin e biznesit - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ngrohtorja deri me 31 Tetor të çdo viti kalendarik duhet të përgatis një Plan Biznesi për vitin e ardhshëm kalendarik. Megjithatë, edhe pse plani i biznesit është hartuar, ai nuk i mbulon të gjitha aktivitetet dhe përmbajta e tij nuk reflekton mundësit reale të ndërmarrjes. Plani i biznesit përmban një SWOT⁴ analizë ku janë përshkruar përparësitë, dobësitë, mundësit dhe rreziqet, mirëpo jo edhe një plan për menaxhimin e rreziqeve sidomos ato që varen direkt nga aktivitetet e ndërmarrjes dhe kanë ndikim më të madh dhe gjasa më të larta për të ndodhur. Kjo situatë ka ardhur si shkak i pamundësisë financiare për të menaxhuar situata si investime me të larta në asetet ekzistuese, çmimi i lartë i lëndës për djegieje, pamundësi e rritjes së tarifës e cila caktohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë etj.

Menaxhmenti kishte zhvilluar aktivitete të pandërprera për sigurimin e investimeve dhe pritjet për investime të reja janë të afërta pasi Ngrohtorja vetëm ka fituar një grant nga EU si IPA II⁵ në vlerë 21 milion € së bashku me Termokos-in për përmirësimin e ngrohjes qendrore me ko-gjenerim. Gjithashtu, ndarja e parcelës për ndërtimin e impiantit ishte bërë nga Qeveria e Kosovës me vendimin e datës 30.09.2016. Problem mbetet rehabilitimi i rrjetit primar të termofikimit dhe nënstacioneve e cila kërkon mjete shtesë dhe menaxhmenti i ndërmarrjes është duke bërë përpjekje të vazhdueshëm të siguroj fonde për këtë projekt.

Rreziku Mangësitë e identifikuar do të dobësojnë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Të hyrat e kufizuara, vjetërsimi dhe vlera e lartë e borxheve dhe të të arkëtushmeve që shumica janë trashëguar nga e kaluara janë faktor që rrisin rrezikun e operimit normal të ndërmarrjes dhe ndikojnë direkt në menaxhimin e rreziqeve të identifikuar.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë përdorur të gjitha mekanizmat për adresimin e çështjeve të identifikuar dhe të bëjë përpjekje për menaxhim të rrezikut në mënyrë më të përshtatshme për t'i zvogëluar ato deri në nivel të pranueshëm.

⁴ SWOT - në Anglisht : Strengths, Weaknesses, dhe Opportunities, Threats, - në Shqip: Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet

⁵ IAP - Instrument i Para Anëtarësimit që Bashkimi Evropian (BE) ju ndanë shteteve të cilat pretendojnë të bëhen anëtare të BE

Çështja 5 - Mos përmbushje e shërbimeve për ngrohje - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Furnizimi me lëndë të parë për sigurimin e ngrohjes termike bëhet nga subvencionimi i Qeverisë, përkatësisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik mirëpo për shkak të vështirësive financiare, Ngrohtorja nuk është në gjendje të sigurojë ngrohje të qëndrueshme për konsumatorët gjatë gjithë sezonit kërkesë kjo sipas Ligjit për energji termike (neni 11.1). Këtë vit furnizimi me energji termike kishte filluar me 01.12.2016 për sezonin e dimrit kjo për shkak të mungesës së lëndës së parë dhe problemeve me vjetërsimin e pajimeve për prodhim dhe rrjetit të distribuimit.
- Rreziku** Mangësitë e identifikuara kanë rezultuar në mos pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe ofrim të dobët të shërbimeve.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë aktivitete shtesë për të siguruar mjetet e nevojshme për përmbushjen e shërbimeve kualitative të ngrohjes.

Çështja 6 - Dobësi në matjen reale të shfrytëzimit të energjisë termike - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Mungesa e pajisjeve matëse të ngrohjes ishte pengës tjetër për një faturim real dhe ngarkesë real ndaj konsumatorëve. Kjo duhet të shërbej si bazë për matjen reale të shfrytëzimit të energjisë termike dhe faturimit real ndaj konsumatorëve. Sipas ligjit për energji termike nr. 05/L-052 (neni 9.2, 30 dhe 35.1) kërkohet që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon pajisje matëse për konsumatorë të kyçur në sistemin e energjisë termike brenda pesë (5) viteve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Mirëpo kjo kërkesë nuk ishte përmbushur ende për shkak të vështirësive financiare përderisa faturimi ende vazhdon me metodën e caktimit të tarifës për konsumatorët pa matje, duke u bazuar në metër katror të etazhit të objekteve (matja e etazhit të objekteve bëhet nga një komision i Ngrohtores).
- Rreziku** Matja jo korrekte e energjisë termike, rritë rrezikun e faturimit të pa saktë dhe të refuzimit të pagesave nga konsumatorët.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore për instalim të pajisjeve matëse të shfrytëzimit të energjisë termike të secili konsumator më qëllim të ngarkesës dhe faturimit të saktë.

2.2.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet, megjithatë këto kontrolle duhet të forcohen për të siguruar raportim të saktë. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 7 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të Ngrohtores ka nxjerrë në pah një raportim financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të ofrimit të shërbimeve. Mirëpo, jo gjithmonë këto raportime kanë qenë të plota dhe të sakta për obligime, llogarit e arkëtueshme, pasurin dhe ekuitetin. Kjo ka ndodh për shkak se evidencat kontabël të trashëguara të cilat nuk janë azhurnuar me kohë edhe pas këshillave tona në memorandumun e auditimit kanë ofruar raportime jo të plota dhe të pa sakta për këto kategori.

Për me tepër, dobësitë e identifikuara tregojnë se kontrollet menaxheriale nuk janë ende të konsoliduara sa duhet për parandalimin apo evitimin e gabimeve eventuale. Gjithashtu, mos zbatimi i plotë i rekomandimeve nga viti i kaluar dhe mungesa e NJAB, janë tregues se kontrollet nuk janë duke u aplikuar në mënyrë efektive.

Rreziku Cilësia e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë e ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e Ngrohtores në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektin e kontrolleve. Mangësitë e identifikuara mund të rezultojnë me raporte të pasakta dhe jo të plota për shfrytëzuesit.

Rekomandimi 7 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.

2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Çështja 8 – Mos themelimi i NJAB-së – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Ngrohtorja nuk kishte të themeluar NJAB, edhe pse këtë vit kishte përfshirë si objektiv kompletimin e stafit dhe kishte parapa edhe pozitën e auditorit të brendshëm që duhet të plotësohej në janar të këtij viti. Për shkaqe financiare dhe mungesës së aplikimit të kandidatëve të kualifikuar sipas konkursit në fund të vitin, e njëjta pozitë ende mbetet e paplotësuar. Kjo pasqyron mungesën e vëmendjes së menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme apo qeverisjes së mirë.
- Rreziku** Mungesa e NJAB zvogëlon sigurinë e menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo rezulton me dobësi të paidentifikuara dhe vazhdim të praktikave joefektive, që mund të pasojnë edhe me humbje financiare për Ngrohtoren.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të konsiderojë mundësin e sigurimit të shërbimit të auditimit të brendshëm në mënyrë që të testoj përshtatshmërinë, efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe operimin e kontrolleve brenda Ngrohtores.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Ngrohtore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet ekzistuese lidhur me menaxhimin financiar të Ngrohtores kanë nevojë për përmirësime. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk janë adekuate, ato nuk kanë marrë në konsiderate shkaqet të cilat mund të ndodhin gjatë vitit që rrezikojnë mos arritjen e objektivave dhe pamundësinë e mbulimit të shpenzimeve. Dhe për këtë, kishte ndryshime mes planifikimit të buxhetit fillestare dhe atij final për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime.

Përderisa, kontrollet në fushën e të hyrave nga aktiviteti i saj kryesor ishin më të mira në krahasim me vitin paraprak. Ngrohtorja kishte arritur të realizoj 99% të planit të të hyrave për vitin 2016. Përkundër kësaj, Ngrohtorja është duke operuar me humbje, si pasoj e tarifave të ulëta dhe kostos së lartë të shërbimeve të cilat nuk mund të mbulohej nga të hyrat e realizuara.

Më tutje, auditimi ka identifikuar mangësi në menaxhimin e pagave të punonjësve dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Ngrohtorja në vazhdimësi nuk arrin të paguan faturën e pagave për punonjësit, për shkak të obligimeve nga vitet e kaluara. Po ashtu, mungesa e një vlerësimi të punonjësve reflekton me pamundësi të matjes së performancës dhe rrezikon përmbushjen adekuate të detyrimeve të kontraktuara. Kontrollet në menaxhimin e mallrave dhe shërbimeve duken të jenë të mira, mirëpo edhe më tutje duhet të punohet për të siguruar pranimin e mallrave sipas raportit të pranimit për të siguruar që mallrat/ shërbimet/ punët pranohen sipas ofertës financiare, specifike të kontratës.

Edhe për kundër aktiviteteve të ndërmarra nga Ngrohtorja, vlera e të arkëtueshmeve dhe detyrimeve ende mbetet e lartë. Vlera e lartë e detyrimit dhe pamundësia financiare për të shlyer këto obligime paraqet gjendjen e vështirësisë financiare për zhvillimin e një aktiviteti normal të biznesit.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga Bordi i Drejtorëve për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin në Ngrohtore.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Ngrohtoren, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e realizuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Kategoritë ekonomike të planifikuara dhe të realizuara në €

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi fillestar 2016	Planifikimi i rishikuar 2016	Realizimi 2016	Realizimi 2015
1	Të hyrat ⁶	740,000	700,000	1,047,819	173,111
2	Shpenzimet	(740,350)	(740,350)	(1,098,384)	(420,919)
3	Fitimi/Humbja (1-2)	(350)	(40,350)	(50,565)	(247,808)

Me buxhetin fillestar sipas planit të biznesit, Ngrohtorja kishte planifikuar edhe të hyra nga inkasimi i borxheve të vjetra sipas ligjit dhe inkasimit të borxheve të vjetra nga gjykata në vlerë 55,000€ dhe me buxhet të rishikuar final kjo kishte ndërruar në vlerë 51,000€. Ndërsa, në tabelë është shpalosur planifikimi i të hyrave që Ngrohtorja pret t'i realizoj nga aktiviteti kryesor i sajë.

Ngrohtorja gjatë vitit 2016, nuk kishte arritur të realizoj të hyra tjera nga grantet apo donacionet, kryesisht aktivitetin e vet e kishte mbuluar nga të hyrat nga shitja dhe subvencionimi i qeveris për blerje të lëndës së parë-mazutit. Të hyrat në 2016 ishin në vlerë 1,047,819€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat e realizuara nga shitja gjatë këtij viti në vlerë 298,026€ dhe të hyra tjera nga subvencionet dhe të hyrat e shtyra nga grantet e donatorëve në vlerë 749,793€ sipas pasqyrës së të ardhurave.

Shpenzimet e vitit 2016 krahasuar me vitin e kaluar janë shumë më të larta për arsye se gjatë 2016 Ngrohtorja ka ofruar nxehje. Operimi i të cilit krijon shpenzime të larta të ujit dhe rrymës, ndërsa në 2015 kompania kishte ofruar vetëm pak ditë nxehje (17 ditë) për shkak të bllokimit të llogarive që kishte ndodh në po atë vit dhe nuk e kanë shfrytëzuar subvencionin e qeveris për 2015 sepse parat ishin në rrezik të konfiskimit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit në €

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet sipas kategorive:	740,350	740,350	1,098,384	420,919
Pagat dhe Mëditjet	140,000	181,000	183,600	147,450
Mallrat dhe Shërbimet përfshirë komunalit	100,350	159,350	169,628	29,480
KMSH	500,000	400,000	584,650	61,760
Zhvlerësimi			160,506	182,229

⁶ Të Hyrat, përfshijnë: të hyrat nga veprimtaria e Ndërmarrjes, nga Grantet dhe nga kreditë (nëse ka)

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti fillestar krahasuar me atë final tregonte trend rritës për shkak të vendimit të Bordit për rikthimin e pagave në gjendjen e me hershme. Vendimi i Bordit është aplikuar për rikthim pasi në vitin paraprak pagat ishin zvogëluar për 5% si pasojë e vështirësive financiare.
- Për Mallra dhe Shërbime, Ngrohtorja kishte buxhetuar komunal, mirëmbajta, riparim, shpenzim tjera administrativë. Buxheti fillestar me atë final ishte rritur si pasojë e rritjes për: obligimin ligjore nga 5,000€ në 50,000€, shpenzimet tjera nga 5,000€ në 8,000€, shpenzimet e rrymës nga 60,000€ në 70,000€ dhe softuerin për financa nga 1,000€ në 2,000€.
- Buxheti fillestar me atë final ishte zvogëluar nga 500,000€ në 400,000€ për shpenzim të lëndës së parë - mazuti si KMSH, për shkak të vendimit të qeverisë. KMSH ka të bëjë me shpenzimin e lëndës së parë-mazutit në vlerë 583,351€ dhe KMSH e ekonomajzerit në vlerë 1,298€. Realizimi është me i lartë së buxheti si pasojë e bartjes së stokut nga viti 2015.

Çështja 9 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i mesëm

E gjetura	Ndërmarrja kishte buxhet final për paga dhe mëditje në vlerë 181,000€ ndërsa kishte realizuar 183,600€, dhe për mallra dhe shërbime buxheti final ishte 159,350€ dhe realizim 169,628€. Këto ndryshime ishin pasojë e planifikimit jo të duhur të buxhetit.
Rreziku	Planifikimi jo i duhur i buxhetit do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të ndërmarrjes dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
Rekomandimi 9	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.

3.2 Të hyrat

Nga veprimtaria e Ndërmarrjes janë realizuar të hyra të faturuara nga shitja në vlerë 289,026€, përderisa në vitin paraprak ishin realizuar 16,219€, kjo për shkak të performancës më të mirë në 2016. Krahasuar me planifikimin prej 300,000€ të hyrat janë realizuar prej 99%.

Tabela 3. Të hyrat e planifikuara dhe të realizuara në €

Përshkrimi	Buxheti fillestar 2016	Buxheti final 2016	Realizimi 2016	Realizimi 2015
Gjithsej të hyrat:	740,000	700,000	1,047,819	173,111
Të hyrat nga aktiviteti kryesor	240,000	300,000	298,026	16,219
Të hyrat nga subvencionet	500,000	400,000	749,793	158,892

Ngrohtorja, me buxhet fillestar kishte planifikuar edhe të hyra nga arkëtimi i borxheve të vjetra (sipas ligjit për falje të borxheve) në vlerë prej 50,000€ dhe arkëtimi i borxheve të vjetra nëpërmes gjykatës prej 5,000€. Gjithashtu, edhe me buxhet final ishte reflektuar i njëjti planifikim mirëpo duke zvogëluar planifikimin për arkëtimin nëpërmes gjykatës për 1,000€ (prej 5,000€ në 1,000€).

Nga ky planifikim, Ngrohtorja ka arritur të realizoj të hyra 298,026€ pothuaj sa kishte planifikuar nga aktiviteti i ngrohjes.

Buxheti për subvencione ka ndërruar me vendimin e qeverisë, dhe Ngrohtorja kishte arrit që në 2016 të marrë subvencion në vlerë 400,000€. Realizimi prej 749,793€ ka të bëjë me subvencionin e 2016 dhe vlerën e bartur të stokut nga subvencionin e vitit paraprak, i cili nuk ishte shfrytëzuar për shkak se Ndërmarrja nuk kishte ofruar shërbim si pasojë e bllokimit të llogarive dhe gjendjes së vështirë financiare.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2.1 Të Hyrat nga veprimtaria e Ndërmarrjes

Realizimi i të hyrave të rregullta për 2016 ishin në vlerë 298,026€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat e realizuara nga shërbimi i ngrohjes dhe nga kyqjet e reja për klientët privat dhe publik.

Çështja 10 - Menaxhimi jo adekuat i të hyrave - Prioritet i lart

E gjetura

Gjatë testimit të kësaj kategorie kemi vërejtur mangësitë në vijim:

- Shpërndarja e faturimit bëhet nëpërmes inkasantit dhe pagesat në shumicën e rasteve pranohen nga inkasanti jo nëpërmes bankës. Parat dorëzohen në arkë dhe në fund të çdo dite ato dorëzohen në llogarinë bankare të Ngrohtores kjo për shkak se shumica e klientëve privat nuk paguajnë nëpërmes bankës. Ekziston një sistem kontrolli tek arkëtimi, mirëpo pranimi i parasë në dorë gjithmonë bart rreziqet në veti sa i përket lëvizjes së kesh-it.
- Gjithashtu, kemi vërejtur se rimbushja e arkës nuk është e rregulluar me një politike e cila përcakton limitin apo kontrollet. Në arkë, mbahen para të imta për nevoja të ndërmarrjes të cilat shpenzohen sipas rregullave për paranë e imët duke mos kaluar vlerën mbi 100€. Mirëpo, parat në arkë nuk depozitohen në llogarinë bankare të kompanisë por ato ndalen direkt nga të hyrat e arkëtuara në bazë të nevojave të kompanisë kjo për shkak të procedurave mbi deponimin dhe tërheqjen; dhe
- Në një rast në kontabilitet, për shërbimin e kyçjes, Ngrohtorja kishte kalkuluar gabimisht TVSh prej 8% edhe pse fatura për këto shërbime ishte në rregull më 18%. Këtu është llogaritur edhe një zbritje për kyçje e cila nuk ishte rregulluar me ndonjë procedurë.

Rreziku

Qarkullimi i të hyrave nëpërmes arkës mund të rezultojë me kontrole të dobëta dhe mundësi të keq përdorimit apo gabimeve. Të hyrat mund të jenë subjekt manipulimit mashtrues ose gabimit.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë aplikuar sisteme të përshtatshme të kontrollit mbi menaxhimin e të hyrave. Me theks të veçantë, duhet të merret në konsideratë hartimi i procedurës për menaxhimin dhe limitet e parasë në arkë.

3.2.2 Të hyrat nga burimet tjera (granatet nga qeveria)

Të hyrat tjera Ngrohtorja në 2016 kishte prezantuar 749,793€. Vlera prej 61,848€ ishte nga grantet e pranuar për mjete nga vitet e kaluara, ku mjetet e përfituara prej grantit paraqiten të ndara nga shuma e grantit të marrë, e cila paraqitet si një e ardhur e shtyrë në pasiven e bilancit. Mjetet e marra amortizohen dhe ngarkohet si shpenzim, ndërsa të ardhurat e shtyra kalojnë në të ardhmen përgjatë jetës së dobishme të mjetit të marr.

Gjithashtu, Ngrohtorja kishte prezantuar edhe të hyra nga subvencionet në vlerë 687,935€ për blerje të mazutit. Kjo ka të bëjë me subvencionimin e qeveris prej 400,000€ për 2016 dhe subvencionin e bartur nga viti paraprak.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2.3 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes llogarisë bankare të Ngrohtores dhe kalkuloohen nga programi kompjuterik i kontabilitetit të Ngrohtores. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave sigurohen nga sistemi i kontroleve të brendshme, duke raportuar për: njësitë, vijueshmërinë, orët e rregullat të punës, mungesat, shujtat apo punë jashtë normës së rregullt. Administrata përpilon një raport të përgjithshëm të pagave duke ju referuar raportit të njërive dhe i njëjti i dërgohet financave. Ngrohtorja ka 32 zyrtarë duke përfshirë edhe bordin. Anëtarët e bordit (4 jo ekzekutiv) paguhen sipas vendimit të aksionarit dhe stafi tjetër paguhet me pagën bazë duke i shtuar përvojën prej 0.5% për çdo vit punë dhe 2.5€ për shujtën për ditë pune.

Çështja 11 - Mangësi në menaxhimin e pagave - Prioritet i lartë

E gjetura Menaxhimi i pagave ishte përcjell me mangësitë si në vijim:

- Paga bazë e kontraktuar për stafin nuk kishte mundësi të verifikohet në mungesë të një rregullore/deklarate mbi caktimin e pagesës dhe kategorizimin e stafit. Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212 (neni 55.4) punëdhënësi duhet të nxjerr një deklaratë për çdo pagë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve dhe me Ligjin nr. 03/L-87 për Ndërmarrje Publike (neni 20.4) obligon komisionin e auditimit të përgatis dhe të zbuloj në mënyrë publike një deklaratë për politiken e kompensimit për drejtorët dhe zyrtarët e Ndërmarrjes Publike.

- Në dosjen e personelit nuk kishte dëshmi mbi vlerësimin e performancës për stafin. Kjo nuk përputhet me kërkesat e Ligjit të Ndërmarrjeve Publike (neni 28.1) ku kërkon që Bordi i Drejtorëve në baza vjetore do të bëjë një vlerësim sistematik të performancës së vet. Kryesuesi është përgjegjës për të siguruar kryerjen e rregullt dhe me kohë të vlerësimit. Vlerësimi do të analizojë performancën e përgjithshme të bordit si dhe efektshmërinë dhe kontributin e anëtarëve individual të bordit. Gjithashtu i njëjti Ligj (neni 34.3.a.b) obligon ndërmarrjen të nxjerr një politikë për titujt, detyrat dhe kompetencat e secilit zyrtar të Ndërmarrjes dhe një politikë mbi rekrutimin e menaxhmentit si dhe vlerësimin e efektshmëris në përputhje me standardet e drejtësisë dhe transparencës. Më tutje, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë se detyrat e caktuara për stafin, sipas marrëveshjes me punëdhënësin ishin apo nuk ishin përmbushur kënaqshëm nga të punësuarit, si matet performanca në punë, apo një përshkrim të kësaj performance e cila mund ti paraprij një përmirësimi në të ardhmen apo përgatitjes së një plani për trajnim adekuat, ngritje në detyrë apo ulje për shkak të performimit të mirë apo jo të mirë.
- Gjatë 2016, Ngrohtorja kishte deklaruar shpenzim të pagave në vlerë 183,600€. Në 2016, Ngrohtorja kishte arrit të paguaj pagat e prapambetura prej korrikut 2014 deri në janar 2016 gjegjësisht 19 paga, nga të hyrat e arkëtuara në vlerë 210,269€. Gjithashtu, si paga të pagueshme Ndërmarrja ka prezantuar vlerën 142,642€ që kanë të bëjnë me pagat e pa paguara të punëtorëve gjatë vitit 2016 (shkurt- dhjetor). Më tutje, Ngrohtorja ishte në obligime edhe ndaj ATK-së për mos pagesën e tatimit, kontributit, ndëshkimit dhe interesit, kjo për shkak të vështirësive financiare të Ndërmarrjes. Vlera e këtyre detyrimeve nga 2010 deri me 31.12.2016 ishte 187,822€ të cilat mbesin për tu paguar në vitet e ardhshme.

Rreziku

Mangësitë e identifikuar nuk ofrojnë siguri mbi përcaktimin real të pagave. Gjithashtu, mungesa e një vlerësimi të punonjësve reflekton me pamundësi të matjes së performancës dhe rrezikon përmbushjen adekuate të detyrimeve të kontraktuara. Obligimet e pambuluara vështirësojnë aktivitetin normal të ndërmarrjes në të ardhmen dhe pasojën me rritje të ndëshkimit dhe interesit dhe mund të rezultojnë me padi për pagat e pa paguara.

Rekomandimi 11

Kryesuesi i Bordit të sigurojë transparencë mbi kompensimin e zyrtarëve në përputhje me kërkesat ligjore dhe të krijoj instrumente mbi matjen /vlerësimin e performancës së stafit. Gjithashtu, duhet të siguroj se janë duke u zbatuar veprime shtesë për zvogëlimin e obligimit për tatime, kontribute, pagat e pagueshme, dhe punëtorët të realizojnë të drejtën në pagës të rregullt për paga dhe mëditje, e drejt kjo e punëtorëve e garantuar me ligjin e punës.

3.2.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 159,350€. Shpenzimet e faturuara të periudhës janë prezantuar në pasqyrën e të ardhurave në vlerë prej 169,628€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të borxheve të këqija, interesit, rrymës, ujit, auditimit, reklama, shpenzime të udhëtimit, reprezentacion, furnizim për zyre, shpenzim të telefonit dhe shpenzim tjera.

Çështja 12 – Mungesa e raportit për pranim të mallrave /shërbimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Në tri raste, Ngrohtorja nuk kishte themeluar komision të pranimit për punët sipas kontratës. Blerja e një “Gjeneratori dhe pompe uji” ishte pranuar nëpërmes urdhër magazinimit në vlerë 565€, “Riparimet në objektin e Kaldatores” ishin pranuar nëpërmes procesit të realizimit të punimeve në vlerë 973€ dhe “Riparimi i Pompave Qarkulluese” në vlerë 2,524 € është pranuar me proces të realizimit të punëve nga përgjegjësi i repartit, e jo me një raport të pranimit nga një komision sipas rregullave. Për më tepër, te rasti “Riparimi i pompave qarkulluese”, urdhëresa për realizimin punëve ishte bërë me 18.01.2016, ndërsa faturimi ishte pranuar para këtij raporti, tri ditë më herët, për shkak se kontrollet nuk ishin vendosur si duhet.

Rreziku Mungesa e raportit të pranimit nuk jep siguri së mallrat/ shërbimet/ punët janë pranuar sipas ofertës financiare, specifikave të kontratës. Mangësitë e identifikuar rezultojnë me kontrolle jo adekuate.

Rekomandimi 12 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur kontrolle adekuate për pranimin e mallrave, shërbimeve apo punëve. Pranimi duhet të bëhet në përputhje me rregullat dhe raporti i pranimit të jetë dëshmi për përmbushjen e kontratës dhe për ekzekutimin e pagesës.

3.2.5 Investimet kapitale

Ndërmarrja operon me pajisjet e trashëguara dhe fituara nga donacionet. Gjatë 2016, Ngrohtorja ka treguar vetëm një aktivitet investues në vlerë 9,870€, që ka të bëjë me detyrimin nga e kaluara e paguar përmes vendimit gjyqësor. Ndërsa në vitin paraprak Ngrohtorja kishte prezantuar investime kapitale në vlere 67,372€.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pasuritë

3.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive jo qarkulluese në pronësi të Ndërmarrjes me 31.12.2016 ishte 1,594,815€.

Struktura dhe ndryshimet tek këto pasuri janë dhënë në tabelën me poshtë:

Tabela nr. 4 Pasuritë sipas kategorive dhe shumave në €

Përshkrimi	Toka	Ndërtesat	Pajisjet dhe Makineritë	Totali
Kosto historike (Vlera blerëse)	210,600	399,716	3,603,114	4,213,430
Zhvlerësimi i akumuluar (deri 2015)	0	214,736	2,221,650	2,436,386
Blerjet gjatë vitit 2016	0	0	0	0
Rivlerësimi i pasurive	0	0	0	0
Zhvlerësimi i vitit 2016	0	19,944	162,285	182,229
Vlera neto në libra me 31/12/2016	210,600	165,036	1,219,179	1,594,815

Çështja 13 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura

Për shkak të evidencave nga e kaluara, Ngrohtorja kishte mangësi në evidentimin dhe prezantimin e regjistrave të pasurisë si në vijim:

- Një investim në Kaldaja 20MW prej 132,424€ nuk ka datë të regjistrimit në regjistrin e pasurisë;
- Një printer 4HP Jet në vlerë 165€ nuk ka datë të regjistrimit në regjistrin e pasurisë;
- Tetë pajisje (stufa, dollap, arka, tavolinë, fshesë) nuk kanë datë as vlerë të regjistrimit në regjistrin e pasurisë;
- Në 40 raste tek pajisjet tjera (siguresa, voltmetër, pjesë, valvulin, kontaktor, etj.) nuk kishin datë të evidentimit as vlerë të regjistrimit në regjistrin e pasurisë.
- Tek 23 pajisje tjera (valvulin, këmbyses, pompa, transformer, agregat, matës i energjisë elektrike, pajisje për përgatitjen e mazutit etj.) në vlerë 476,190€ nuk dihet data e regjistrimit në regjistrin e pasurisë.
- Për me tepër tek pajisjet tjera dy nënstacione në vlerë prej 7,793€ nuk kanë datë të regjistrimit në regjistrin e pasurisë; dhe

- Gjithashtu, sipas standardeve kërkohet të bëhet rivlerësim i pasurive, mirëpo, Ngrohitorja nuk kishte bërë rivlerësim të pasurisë si shkak i mungesës së eksperteve për këtë lami.

Rreziku Mangësitë e identifikuara reflektoje prezantim jo të drejt dhe të plot të shpenzimit të zhvlerësimit dhe gjendjes reale të pasurisë.

Rekomandimi 13 Kryesuesi i Bordit duhet të zbatoj një plan të detajuar të kontrolleve duke siguruar mekanizma shtesë për evidentimin e këtyre gabimeve me qëllim të prezantimit të saktë dhe të plot të pasurisë në PFV.

3.3.2 Trajtimi i parasë së gatshme

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshinë bilancet e parave të gatshme në llogaritë bankare dhe në arkë. Ngrohitorja në fillim të vitit 2016, sipas PFV kishte prezantuar para në vlerë 43,593€ ndërsa në fund të vitit kjo vlerë ishte 4,949€.

Arkëtimi i parasë vetëm nga aktivitet operative sipas pasqyrës së rrjedhës së parasë, ishte në vlerën 754,410€, krahasuar me vitin paraprak arkëtimi i parasë ishte më i lartë për 83,114€. Shpenzimi i parasë vetëm për aktivitete operative ishte 781,579€ krahasuar me vitin e kaluar kishte një rritje prej 222,238€.

Shpenzimi i parasë nga aktivitetet inventive ishte 9,871€ paguar sipas një vendimi gjyqësor për detyrimin nga vitet e mëhershme. Krahasuar me vitin e kaluar prej 67,372€, këto shpenzime ishin zvogëluar për 57,457€.

Shpenzimi i parasë për aktivitetet financuese ishte në vlerë prej 1,605€, në krahasim me vitin e kaluar prej 3,188€ këto shpenzime ishin zvogëluar prej 1,583€.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3.3 Të arkëtueshmet

Në PVF, Ngrohtorja ka prezantuar vlerën e të arkëtueshmeve prej 1,598,011€. Kjo përbëhet nga llogaritë e arkëtueshme tregtare prej 1,123,484 të Ngrohtores të cilat janë shuma të mjeteve që klientët i detyrohen ndërmarrjes për shërbimet që i kanë përfituar. Gjithashtu, përbëhet nga të arkëtueshmet tjera ndaj TVSH në vlerë 252,551€, një avanc i dhënë prej 13,879€ që ka të bëjë me një pagesë tepriçë për një klient i cili ka tërheqë parat nga një vendim gjyqësor, stoqet në vlerë prej 203,148€ (që kanë të bëjnë me stoqet e mazutit 96,075€ dhe stok i mallit 107,073€), si dhe pasuri qarkulluesi duke përfshirë edhe paranë prej 4,949€.

Ngrohtorja kishte prezantuar listën sipas kërkesës së ligjit për faljen e borxheve për vlerën e të arkëtueshmeve deri me 31.12.2008 prej 1,086,030€ dhe nga 01.01.2009 deri me 31.12.2014 vlerë prej 913,894€. Ngrohtorja kishte hyrë në marrëveshje me klientët, dhe 345,711€ ishin borxhe të falura deri me 31.12.2008 ndërsa marrëveshjet për pagesë ishin prej 119,660€ të cilat janë duke u paguar sipas këtyre marrëveshjeve. Deri me 31.12.2016 vlera e bartur për tu inkasuar nga këto marrëveshje është 66,130€. Gjithashtu, gjatë 2016, Ngrohtorja kishte dërguar në procedurë të përmbartimit nëntë (9) klientë për borxhin e papaguar.

Mirëpo, edhe për kundër aktiviteteve të ndërmarra nga menaxhmenti vlera e të arkëtueshmeve ende mbetet e lartë, borxhlinjtë kryesor mbetet Komuna e Gjakovës/aksionari për obligimin e pashlyer vetëm për ngrohje të shkollave në vlerë prej 229,567€.

Çështja 14 - Mangësi në menaxhimin e të arkëtueshmeve - Prioritet i lart

E gjetura Ngrohtorja kishte prezantuar borxhe të këqija prej 106,944€ të cilat kanë zvogëluar llogaritë e arkëtueshmeve. Gjatë vitit 2016, ndërmarrja ka njohur shpenzime të borxhit të keq 43,000€ kjo për shkak se në vitin vijues pritet që edhe disa nga të arkëtueshmet të zvogëlohen sipas ligjit për falje të borxhit. Gjithashtu, llogaria e borxhit të keq është zvogëluar edhe nga viti i kaluar për vlerën 300,611€ si pasojë e faljes së borxhit duke rikthyer vlerën 6,553€ për mos përmbajtje të marrëveshjes nga klientët. Gjendja e bartur në fillim të vitit prej 358,002€ prezanton vlerën e borxhit të keq nga e kaluara për të cilën ndërmarrja nuk ka një politikë se si e njuh këtë llogari.

Rreziku Shënime kontabël nuk japin pasqyrim të drejtë për llogaritë e arkëtueshmeve duke rezultuar një pasqyrim jo të qëndrueshëm për nevojat e raportimit financiar.

Rekomandimi 14 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet se është bërë harmonizimi i shënimeve kontabël të arkëtueshmeve me qëllim të paraqitjes dhe prezantimit të drejtë dhe në përputhje me standardet e raportimit financiar. Gjithashtu, të vlerësojë nxjerrjen e një politike kontabël në bazë të standardeve dhe rregullave në fuqi për lejime dhe borxhet e këqija.

3.4 Kapitali dhe Detyrimet

3.4.1 Kapitali

Në Pasqyrave Financiare Vjetore, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Përshkrimi	Me 31.12.2016	Me 31.12.2015
KAPITALI	1,571,709	1,655,499
Kapitali themeltar	3,782,592	3,782,592
Kapitali rezerve	354,645	387,870
Fitimet/Humbjet e bartura	(2,514,963)	(2,267,155)
Fitimet/Humbja e vitit aktual	(50,565)	(247,808)
Rezerva e rivlerësimit	0	0

Ngrohtorja është duke operuar me humbje, kjo si pasoj e tarifave të ulëta dhe kostos së lartë të shërbimeve të cilat nuk mund të mbulohen nga të hyrat e realizuara. Humbja është pasoj edhe e vlerës së lartë të zhvlerësimit të pasurive që posedon ndërmarrja. Mirëpo, përkundër këtij fakti Ngrohtorja si ndërmarrje publike e themeluar nga Aksionari/Komuna, pret mbështetjen me grande dhe subvencione nga aksionari. Për më tepër operimi i kësaj kompani është i domosdoshme për ofrimin e shërbimit të ngrohjes /energjisë termike.

3.4.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve afatshkurta prej 699,613€ ka të bëjë me obligimet e pagueshme tregtare 216,006€, tatimet e pagueshme 258,356€, pagat e pagueshme-obligim për paga të punëtorëve 142,642€, detyrimet tjera-tatimin në fitim 78,736€ dhe avanc i pranuar nga klientët 3,872€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Krahasuar me vitin e kaluar që ishin 780,012€ obligimet tregonin një trend zvogëlues. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Ngrohtorja dhe është shqyrtuar më në detaje në nënkapitullin 3.3.

Gjithashtu, Ngrohtorja ka prezantuar edhe detyrim afatgjate ndaj bankave dhe të hyrat e shtyra prej 921,506€ që kanë të bëjnë me detyrimet nga të hyrat e shtyra -mazuti prej 123,176€ dhe prej donacioneve në vlerë prej 798,330€.

Vlera e përgjithshme e detyrimeve të prezantuara në bilancin e gjendjes ishte prej 1,621,119€.

Çështja 15 - Mangësitë në menaxhimin e detyrimeve -Prioritet i lartë

E gjetura

Gjithsejtë vlera e detyrimeve afatshkurtra të prezantuara në vitin 2016 ishte 669,613€. Vlera e lartë e detyrimit dhe pamundësia financiare për të shlyer këto obligime paraqet gjendjen e vështirësisë financiare për zhvillimin e një aktiviteti normal të biznesit. Për me tepër, menaxhimi i detyrimeve të prapambetura ishte përcjellë me mangësitë si në vijim:

- Ngrohtorja, gjatë kësaj periudhe kishte treguar detyrim të prapambetura tregtare në vlerë 216,006€, vlera e detyrimeve mbetet e lartë përkundër faktit se janë duke u bërë përpjekje të vazhdueshme që këto detyrime të menaxhohen. Detyrimet e papaguara janë ato për rrymën, ujin, tatimit në pronë dhe detyrimet ndaj disa operatoreve ekonomik për furnizim apo përfundimin e punëve të ndryshme. Këto detyrime në fillim të vitit ishin prezantuar si llogari të pagueshme tregtare prej 245,884€.
- Vlera e detyrimeve të bartura ndaj ATK si obligim për TVSH, tatimin në burim dhe kontributet ishte 258,356€ duke i shtuar ndëshkimet dhe interesat për shkak të vonesa në kryerjen e obligimeve. Historiku i borxheve të papaguar daton nga 2009 deri me tani.
- Ngrohtorja kishte paguar detyrimin sipas aktvendimit të gjykatës me nr. 114/2013 për një operator sipas një marrëveshjeje të vitit 2010 në vlerë 9,870€ për “zgjerimin e rrjetit primar të termofikimit-servisim/rregullim i brenerave SAACKE” duke i shtuar edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, procedurës gjyqësore, interesit në vlerë prej 1,599€. Pagesa ishte bërë pas urdhëresës për bllokim të llogarive me datë 12.02.2016 për një detyrim të para 6 viteve, si pasojë e mungesë së mjeteve financiare; dhe
- Ndërmarrja gjatë kësaj periudhë kishte arrit të paguaj pagat nga korriku i 2014 deri në janar 2016 gjegjësisht 19 paga. Detyrimin e bartur nga viti i kaluar si detyrime afatshkurtra për pagat e pagueshme që ishin prej 195,988€ ishin zvogëluar dhe prezantuar në fund të vitit 142,642€. Mirëpo, edhe përkundër përpjekjeve për zvogëlim të këtyre detyrimeve Ngrohtorja ende nuk kishte arrit të bëjë pagesën e detyrimit për pagat e deklaruara për 11 muaj të kësaj periudhe kjo si shkak i gjendjes financiare.

Rreziku

Vlera e lartë e detyrimeve dhe vjetërsia e tyre rezulton me pagesa shtesë, si ndëshkime, interesa dhe shpenzime gjyqësore të cilat rrisin rrezikun me ballafaqime në procese gjyqësore.

Rekomandimi 15

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa të nevojshme për sigurimin e buxhetit, me qëllim të zvogëlimit të detyrimeve të prapambetura dhe detyrimeve të vitit 2016.

3.4.3 Trajtimi i detyrimeve Kontigjente

Sipas Standardeve detyrimet kontigjente përkufizohen si një obligim i cili është rrjedhojë e ngjarjeve të kaluara dhe vlera monetare e obligimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme. Ngrëtorja kishte shpalos detyrime kontigjente për dy raste në procedurë gjyqësore të cilat aktualisht gjinden në procedurën ankimore.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2015	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. Mbivlerësim i asetëve	<p>Siç është shpалosur në shënimin 7 të pasqyrave financiare përcjellëse bilanci i llogarive të arkëtushmet me 31.12.2015 është 1,196,539€, e cila shuma ka të bej me borxhet e klientëve nga vitet e mëparshme. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedura standarde dhe alternative të auditimit, të vërtetojmë nëse kompania do të jetë në gjendje të inkasoja vlerën e llogarive të arkëtushme të prezantuara.</p> <p>Rekomandojmë që menaxhmentin e ndërmarrjes të bëjë analiza të detajuara në lidhje me të arkëtushmet e pa mbledhshme dhe të këtë evidenca se janë bërë përpjekjet substanciale për të vjelë borxhin në mënyrë që të bëhen vlerësime reale të llogarive të arkëtushme të mbledhshme dhe provizionimin e borxheve të këqija.</p>		Në proces të zbatimit, ndërmarrja ka hyrë në marrëveshje sipas ligjit për falje të borxhit me disa klient për faljen e borxhit deri në 2008 dhe marrëveshje për pagës pas 2008 deri në 2014 gjithashtu në këtë vit kishte marrë hapa shtesë për dërgimin e disa lëndëve tek përmbaruesi.	
2. Kërkesat tjera	<p>Siç është shpалosur në shënimin 8 Ndërmarrja në pasuri qarkullues ka prezantuar të arkëtushme në vlerë 246,081€ që ka të bëjë me kërkesat e TVSH ndaj ATK-së. Në deklaratat mujore TVSH-ja për vitin 2015 nuk figuron një gjendje e tillë. Kjo kërkesë nuk përputhet me gjendjen në ATK.</p> <p>Rekomandojmë që të behën barazimet e nevojshme në mes të zërave në pasqyrat financiare që kanë të bëjnë me tatime dhe gjendjen e ATK ashtu që të mos këtë diferenca dhe mospërputhje ne mes të zërave të pasqyrave financiare dhe gjendjes në ATK të atyre zërave.</p>	Është zbatuar, ndërmarrja ju ka nënshtruar një kontrole nga ATK, deri në muajin e 11 inspektori ka bërë korrigjimet e nevojshëm për TVSH. Ndërsa në muajin 12 kjo gjendje përputhet midis deklaratës se TVSH dhe kërkesave për TVSH të prezantuar në PVF.		

3. Kostoja e mallrave të shitur	<p>Siç është shpalosur në shënimin 14, kostoja e mallrave të shitura në pasqyrën e të ardhurave 61,760€ dallon nga ajo në raportin e CD⁷ për ATK 74,622€ për 12,861€, për të cilën shumë është ndikuar edhe rezultati financiar i ndërmarrjes.</p> <p>Rekomandojmë që të behën harmonizimet në mes të KMSH-së së paraqitur në Pasqyrën e të ardhurave dhe KMSH-së të paraqitur në raportin e CD për ATK.</p>		Diferencat janë evidente, kjo për shkak se raportimi në CD përgatitet sipas kërkesave / politikave të ATK.	
4. Paraja e gatshme	<p>Ne kemi vërejtur se saldo e arkës me datë 15.11.2015 ka qenë në shumë prej 1,663€. Ne konsiderojmë se kjo sasi e parës e mbajtur ne arkë është e panevojshme për nevojat ditore të kompanisë.</p> <p>Rekomandojmë që menaxhmenti të bije vendim mbi maksimumin e arkës ashtu që parat e gatshme mbi atë maksimum të depozitohen në bankë në fund të orarit të punës.</p>		Deri me tani ndërmarrja ka draftuar një rregull dhe procedurë për procesin e buxhetimit dhe kontrollit të shpenzimeve ku parashihet limiti i arkës, mirëpo e njëjta pritet të miratohet nga bordi i drejtorëve.	

⁷ CD - është emërtim për "Formularin e deklarimit vjetor dhe pagesave për tatimin në të Ardhura të Korporatave".

Shtojca IV: Letër konfirmimi



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: +381 (0) 390 328 329
E: info@ngrohtorja.org

Nr. i Biznesit: 70325312
Nr. Fiskal: 600172613
www.ngrohtorja.org

Më 05.06.2017
Nr. 260

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të NPL Ngrohtores Gjakova Sh.A., për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Malush Tullumi

Kryesues i Bordit të Drejtoreve

Data:05.06.2017, Prishtinë,



z. Admir Shala

Kryeshef Ekzekutiv,

Data:05.06.2017, Prishtinë,